



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1598, datë 03.05.2011**

**Për**

**“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri dhe Vodafone Albania sh.a ”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 03.05.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri dhe Vodafone Albania sh.a.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 49, neni 50 pika 1 dhe neni 60 e vijues, pika te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;

5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullore e Brendshme” të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim nr. 170, datë 24. 04. 2004 të Këshillit Drejtues të ERT-së, , e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918,

### K Ë SH I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresë e Unifi Holdings datë 11.04.2011 (AKEP: nr. 632 prot, dt. 12.04.2011) “Kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje” drejtuar AKEP;
  - Shkresa e Vodafone AL, nr. CEO/028/E.Xh datë 21.03.2011 “Parashtrime të Vodafone AL mbi ankesen e Unifi Holdings të datës 16.02.2011”;
  - Korrespondenca me e-mail midis palëve;
  - Relacion shpjegues mbi projektvendimin (*Relacioni*);
- si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

### V Ë R E N:

1. Unifi Holdings me shkresën nr. 632 prot, datë 12.04.2011 “Kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes” i drejtohet AKEP me kërkesën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Unifi Holdings Inc dega Shqipëri (*këtu e më poshtë Unifi*) dhe Vodafone Albania sh.a;
2. Unifi konsideron se, Vodafone AL nuk ka pranuar kërkesën e përsitur të Unifi-t për lidhjen e Marrëveshjes së Interkoneksionit detyrim që i lind nga Vendimi nr. 1211, datë 31.03.2010 i KD të AKEP;
3. Unifi thekson se bisedimet me Vodafone AL kanë filluar që prej vitin 2010, ku fillimisht i ka kërkuar Vodafone AL interkoneksion ndërkombëtar, pasi Unifi mer statusin e një operatori të regjistruar në Shqipëri i ka kërkuar Vodafone lidhjen e një marrëveshje kombëtare interkoneksioni, por të dyja kërkesat e mësipërme janë refuzuar nga ana e Vodafone;
4. Unifi vlereson se, fillimisht me Vodafone ka shkëmbyer draftin e propozuar të një marrëveshje ndërkombëtare interkoneksioni ku në të cilin Unifi i kërkon Vodafone AL të zbatonin midis tyre tarifën kombëtare të terminimit të përcaktuar nga AKEP në vlerën prej 10.50 lek/min duke argumentuar se kjo tarifë do të ishte e zbatueshme për shkak të regjistrimit të shoqërisë kontrolluese të Unifi Communications Inc në Shqipëri apo Unifit si një operator i autorizuar në Shqipëri dhe se në draft MI midis Vodafone dhe Unifi duhet bërë një ndryshim në aneksin C, e cila i referohet tarifës së terminimit në masën 15.07 Eurocent/min në rrjetin e Vodafone, e cila bazuar në Vendimet e AKEP është vendosur në masën 10.50 lek/min duke insistuar në nënshkrimin e MI sa më shpejt midis palëve;

5. Për sa më sipër Vodafone Albania me shkresën me ref. LGD/0122/AC datë 11.05.2010 i drejtohet Unifi duke e sqaruar se, për fillimin e negociatave për lidhjen e MI me Vodafone AL në zbatim edhe të RIO së Vodafone AL miratuar me VKD nr. 527, datë 30.12.2008, ndryshuar me VKD nr. 628, datë 10.02.2009, Unifi duhet të këshillohet me parë me këtë dokument dhe të vërë në dispozicion të Vodafone AL informacionin teknik për të projektuar nje zgjidhje teknike optimale;
6. Unifi konsideron se i gjithë informacioni i kërkuar nga Vodafone AL, nëpërmjet shkresës së Vodafone AL më datë 11.05.2010 është plotësuar dhe dërguar me email nga Unifi më datë 15.06.2010;
7. Gjithashtu, Vodafone AL i kërkon Unifi dokumentacionin e regjistrimit të shoqërisë Unifi dega Shqipëri si provë të regjistrimit të shoqërisë tek autoritetet tatimore Shqiptare;
8. Vodafone i përgjigjet kërkesës së Unifi duke organizuar një takim në zyrat e Vodafone me datë 15.07.2010, gjatë këtij takimi përfaqësuesit e Vodafone deklaruan se Unifi nuk kishte të drejte me kerkesën e tij për lidhjen e MI, sepse ai ende nuk operon me rrjete në Shqipëri;
9. Për sa më sipër Unifi më datë 21.07.2010, i drejtohet Vodafone me kërkesën për t'ju kthyer negociatave, lidhur me marrëveshjen ndërkombëtare të shërbimeve të telekomunikacioneve, që kishin filluar ne vitin 2010. Unifi këtë kërkesë ndaj Vodafone AL e përsërit më datë 03.10.2010, për të cilën konsideron se nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Vodafone;
10. Unifi sqaron se, Vodafone me shkresën e datës 12.01.2011 argumenton se, lidhur me interkoneksionin zanor bazuar ne rregulloren në fuqi dhe tarifave të migrimit në nivel kombëtar, Vendimi i Vodafone është që të marrë trafikun direkt nga bartësit ndërkombëtar me të cilët Vodafone bashkëpunon në nivel grupi kështu që nuk ka vend për marrëveshje lokale;
11. Për sa më sipër, Unifi vlerëson se nuk ka asnjë pengesë ligjore të më sipër përmëndura nga Vodafone, si dhe bazuar në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe në kuadrin rregullator, kërkon që AKEP të ndërhyjë duke Urdhëruar Vodafone AL të nëshkruajë marrëveshje kombëtare interkoneksioni me Unifi në bazë të ofertës referencë të interkoneksionit të Vodafone Albania të miratuar nga AKEP;
12. Vodafone AL, me shkresën nr. 124/9 prot, datë 21.03.2011 “Parashtrimet Vodafone Albania mbi ankesen e Unifit Holding të datës 16.02.2011” , sqaron se:
  - Unifi Communications Inc, është person juridik i regjistruar dhe themeluar në bazë të legjislacionit të shtetit Delaware në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i cili ka kërkuar të lidhë marrëveshje ndërkombëtare me Vodafone Albania;

- Vodafone AL konsideron se Unifi Communications nuk është një operator Shqipëtar dhe Vodafone AL nuk ka një detyrim rregullator që të lidh marrëveshje interkoneksioni me të;
  - Vodafone AL thekson se, ka liri të plotë tregtare që të negociojë të lidhë ose jo marrëveshje ndërkombëtare për shkëmbimin e trafikut ndërkombëtar me shoqërit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për pasojë pretendimet e Unifi Holdings se refuzimi i Vodafone AL për të lidhur marrëveshje me Unifi Communications është i pa bazuar në ligj;
  - Vodafone AL, në lidhje me kërkesën e Unifi Holdings për të lidhur marrëveshje interkoneksioni kombëtare, thekson se gjatë takimit me përfaqësues të Unifi Holdings është sqaruar se në zbatim të nenit 5.1 dhe 5.3 e drejta e interkoneksionit në Shqipëri i përket vetëm operatorëve që operojnë rrjet publik telefonik dhe ofrojnë shërbime telefonike të disponueshme për publikun në tregun shqiptar;
  - Gjithashtu Vodafone AL konsideron se, me qënë se Unifi Holdings nuk ofron një rrjet të komunikimeve elektronike në Shqipëri, nuk ka se si të fitojë të drejtën e interkoneksionit kombëtar në bazë të kuadrit lgjor dhe rregullator Shqiptar;
  - Vodafone AL, në lidhje me komunikimin e datës 12.01.2011 me email midis Unifit dhe Vodafone AL, sqaron se komunikimi ka të bëjë me intrekoneksionin ndërkombëtar dhe jo atë kombëtar, dhe se në thelb teksti i emailit shpjegon se Vodafone AL në kontekstin e interkoneksionit ndërkombëtar preferon që të lidhë marrëveshje vetëm me operatorë ndërkombëtar të përgjedhur dhe miratuar nga Grupi Vodafone, pra nuk ka liri veprimi për Vodafone AL që të përzgjedh se me cilin operator ndërkombëtar do të lidhë këto marrëveshje;
  - Së fundmi Vodafone AL kërkon që AKEP të rrëzojë kërkesën e Unifi Holdings për interkoneksion kombëtar duke qënë se operatori në fjalë nuk operon me rrjet të komunikimeve elektronike dhe nuk ofron shërbime të telefonisë publike sipas përcaktimeve të Rregullores së Akses Interkoneksionit,
  - si dhe
  - Të mos marrë parasysh kërkesën për lidhje interkoneksioni për operatorin Unifi Communications duke qënë se është person juridik i huaj dhe i paregjistruar në Republikën e Shqipërisë në bazë të legjislacionit Shqiptar në fuqi dhe pa autorizim përkatës nga AKEP sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike;
13. AKEP çmon se sipërmarrësi “Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri” ka paraqitur kërkesën ankimore në përputhje me nenin 7 të Rregullores nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjes” miratuar me Vendimi nr. 1296, date 11.06.2010 të KD të AKEP;
14. AKEP sqaron se, sipërmarrësi “Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri” me “Konfirmimin e Njoftimit sipas Autorizimit të Përgjithshëm datë 13.01.2010 të AKEP” është një sipërmarrës i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike sipas kushteve të përcaktuara

në Ligj nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;

15. Duke qenë se, sipërmarrësit Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri dhe Vodafone Albania sh.a., megjithë negociatat, takimet dhe përpjekjet e bëra, nuk kanë arritur të bien dakord mbi lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit, AKEP në zbatim edhe të nenit 50 të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me inisiativën e AKEP,

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brëndshme,

### **V E N D O S:**

1. Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis “Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri” dhe “Vodafone Albania” sh.a dhe.;
  2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me përbërje si:
    - Jonida Gjika Kryetar
    - Jetmir Braha Anëtar
    - Ded Jakaj Anëtar
    - Florida Çela Anëtar
    - Esmeralda Dervishi Anëtar
  3. Të njoftohen palët e interesuara “Unifi Holdings INC Dega Shqipëri” dhe “Vodafone Albania” sh.a për fillimin e procedimit administrativ;
  4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
  5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)
- Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

### **ANËTARË:**

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**